



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 1720/k Prishtinë 10.07. 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI GJEODEZI

Studenti **Elita Selimi** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Përdorimi I kombinuar i stacionit total me skaner lazerik per krijimin e bazamentit gjeodezik nL funksion te punimeve gjeodezike në hekurudha** ” në programin e studimeve Gjeodozi dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Abstrakt

Dimë se transporti hekurudhor është një ndër transportet kryesore dhe të rëndësishme së lart në botë, e veçanërisht për një shtet si Gjermania që këtë lloj të transportit e ka shumë të zhvilluar, e të shfrytëzueshëm. Me kalimin e viteve gjithnjë e më shumë lind kërkesa për rindërtimin, ndërtimin, e kontrollimin e hekurudhave, krijimin e data bazave me të dhëna sa më detaje për hekurudhat dhe rindërtimin e elementeve tjera përcjellëse në hekurudha. Gjatë kësaj teze diplome do të shqyrtojmë metodologjitë e ndërtimit të rrjetit gjeodezik, matjen dhe kompensimet e tyre. E përveç kësaj ky punim do të kontribuoj në pasurimin dhe zgjerimin e njohurive në fushën e skenimit, fushë e cila është pak e trajtuar dhe pothuajse e papërdorur nga ana shtetërore në Kosovë, mirë po nga e cila kemi shumë benefite, pasi që mund të themi se nga skaneri lazerik mund të marrim atë çfarë shikon syri i njeriut, dhe të kemi koordinata(x,y,z) për çdo element që na sheh syri është një benefit që duhet të shfrytëzohet. Gjithashtu nga ky punim do të shohim metoda të reja për matje me kode nga të cilat e lehtësojmë punën e një gjeodeti në zyrë. Jashtë këtyre elementeve që i kemi lartcekur, do e paraqesim edhe krahasim e matjeve me total stacion dhe përfitimin e koordinatave nga skaneri lazerik, dhe do arrijmë në një përfundim se skaneri lazerik gjen përdorim të gjerë në fushën e gjeodezis, e njëkohësisht edhe në shumë fusha tjera si ajo e arkitekturës, historisë etj..

Për elaborimin e këtij punimi është përdorur projekti i stacionit kryesor hekurudhor të Düsseldorf-it, janë përdorur matjet dhe skanimet e bëra aty për arritjen e rezultateve si plani ekzistues, profilet tërthore me qëllim të rindërtimit të çative, e gjithashtu përfundimi i arritur nga krahasimi i dy instrumenteve është mundësuar nga matjet dhe skanimet e bëra në hekurudhat e stacionit kryesor në Düsseldorf. Përveç këtij projekti kemi përdorur edhe projektin për skenimin e Universitetit të Bonn-it me qëllim të renovimit të tij, mirëpo ruajtjen e pamjes dhe detajeve siç janë tani, në këtë punim të dhënat e përfituara nga skanimet në Universitetin e Bonn-it janë shfrytëzuar për elaborim më detaj të përpunimit të skenimeve, pasi që ishte një terren më delikat.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimitarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimitarisë.